Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 142/17
Datë/Datum 05.06.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **"Korporata Energjetike e Kosovës"**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues Mentor Shala - Ekspert Teknik		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr.142/17 OE **"Audit Group" - Prishtinë.**		
Datë:	05.06.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 18.05.2017 me Nr. 142/17 nga OE **"Audit Group" – Prishtinë,** për shqyrtimin e lëndës "**Furnizim me paisje për detektimin e helimut**" me numër të prokurimit KEKO 16/105/121 , të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Korporata Energjetike e Kosovës.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues –" **Korporata Energjetike e Kosovës"**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **"Audit Group"**

		25.05.2017		25.05.2017		05.06.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 18.05.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 142/17 e parashtruar nga OE **"Audit Group" sh.p.k** me seli në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me paisje per detektimin e helimut"**, me nr. të Prokurimit: **KEKO 16 150 121**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – **Korporata Energjetike e Kosoves.**
Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **"Korporata Energjetike e Kosoves.**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues „ Audit Group" sh.p.k , me seli në Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE **„ Audit Group", sh.p.k** me seli në **Prishtinë**, *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 7 , 59, 60, 56 dhe 72, te LPP-se

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

1.Pika 1 ankimore.

Opinioni i panelit të KEK-ut për OE fitues ERA TRADE është i pabazuar sepse OE fitues me prodhuesin PFEIFFER VACUUM Gjermani nuk e ka kopje marrvëshjen me PFEIFFER VACUUM Austria i cili e autorizon SCAN d.o.o.Sloveni për shitjen e produkteve të PFEIFFER VACUUM(shiqo oferten e OE fitues ISO 14001 2004 është e PFEIFFER VACUUM Gjermani,ISO 9001 2008 është e Trinos Vakuum Sistems Gmbh Germany për të cilen ska kurrfar autorizimi edhe pse e njejta prodhon dhoma vakumi e jo detektor heliumi),nuk është plotesuar kërkesa në seksioni II-neni 9,2 pika 1 te FDT te AK.

2.Pika 2 ankimore.

Kërkesa e AK për sqarim shtese drejtuar OE fitues me pytje për ditet e trajnimit është bere shkelje e nenit 59 pika 2 dhe 4(devijime nga kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontrates dhe në dosjen e tenderit)gjë që është kuantifikuar një gjë e tille dhe me këtë është shpall fitues OE, ka shkelje se tani e ndrron opertaorin trajnues nga PFEIFFER VACUUM Gjermani në Scan d.o.o Slovenija. 3.

Pika 3 ankimore.

Te Aneksi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme,kolna e ofruar (përshkrimi) OE fitues deklaron malli i ofruar në këtë oferte është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuar në DT Furnizim me paisje për detektimin e Heliumit KEKO-16-105 121. nuk e plotson kërkesen e nenit 3.1 pika a.sepse këtu OE fitues ka ofru produkte ekuivalente e jo të gjitha ato që kërkohen në Aneksin 1. Te FDT;ndersa ne e

kemi ofrutabelen e ekuivalences e mbulon deklaraten e nenit 3.1 pika a. Dmth nuk ka vlersuar drejte paneli i AKdhe na ka marr si kriter eliminimi,sepse kriteri te Aneksit 1. Neni 3.1 pika a te FDT është i plotësuar nga ne,më konkretisht kjo deklarate është obligative kur mungojn dëshmit e nënvizuara të specifikimet teknike në katalogjet e prodhuesit e në oferten tone të gjitha jane të nënvizuara në detale edhe më mire se specifikimet teknike që AK i ka listuar(vrejtje:e kundërta le të dëshmohet me LPPRK) 4.

Pika 4 ankimore.

Ne seksioni II-neni 9.2 pika 3 te FDT te AK. Shkelje e panelit të tanishëm që ka shpall fitues OE në fjalë por shkelje edhe nga Eksperti teknik i OSHP i cili ka vleresuar në emër të ekspertit shqyrtues të prokurimit , sepse këtu kemi të bëjmë me dokumentacion administrativ e jo të dhëna teknike për të cilat do ishin në kompetencen e tije. Vet fakti se në Aneksin 1 të FDT te AK i ka ndare me numra pozicionet e paisjes dhe ne Seksioni II-neni 9.2 pika 1 të FDT te AK kërkohet: Autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar (të bashkangjitur kopja e marrëveshjes me prodhuesin), për shitjen e produkteve që ofroni.OE fitues ka ofrue nëpër pozicione prodhues të ndryshëm çka nuk e ka plotësue këtë kriter.Sikur OE fitues ta kishte shkru për pozicionin 1prej pikes 1.1- 1.9 dhe pozicionin 2 prej pikes 2.1-2.3 prodhuesin me të cilin mbulohet me autorizime,inareveshje mes dilerve dhe prodhuesve dhe me ISO dhe kataloge gjegjëse do ishte okej çka po mendon eksperti tekinik i OSHP i cili pohon se kjo është një 5% i devijimeve nuk është materiale çka është opinion i paqëndrueshëm se këtu skemi të bëjmë me asfar % dhe rënd e ka shkel nenin Nenin 56 LPPK pika 3 dhe Seksioni II-neni 92 pika 1 dhe 3 te FDT te AK, në vazhdim:nga DT te AK.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar (të bashkangjitur kopja e marrëveshjes me prodhuesin), për shitjen e produkteve që ofroni.(Te OE fitues mungon kopja e marrvëshjes ndërmjet Prodhuesit : Pfeiffer Vacuum GmbH nga Gjermania dhe Distributorit: Pfeiffer Vacuum Austria Gmbh dhe ISO 9001 2008 e Pfeiffer Vacuum GmbH nga Gjermania ai ka në oferte ISO 14001 2004.ndërsa ISO-n 9001 2008 te Trinos Vakuum-Systeme GmbH bashkangjesim dëshmin e cila prodhon dhoma vakumi e jo detektor heliumi për të cilen prap ska kurfar autorizimi)

3. Katalog dhe/apo vizatim të vërtetuar nga prodhuesi me përshkrimet teknike detale për te gjithë artikujt që ofertoni. Në katalog/vizatim (specifikim) të nënvizohen artikujt që keni ofertuar për çdo pozicion të kërkuar në këtë DT.(OE fitues edhe pse oferton me prodhues te ndryshëm shiqo kolonen në tabelen malli i ofertuar ku e bashkangjet katalogun e prodhuesit të pa nënvizuar karakteristikat teknike, por autorizimet për keto pozicione i mungojn)Eksperti teknik i OSHP e bazon ankesen e OE fitues dhe kthen lënden në rivlersim duke ju drejtuar panelit të AK në pranime të dokumentacioneve shtese(të cilat neve nuk na janë bere të qaseshme me rastin e shiqimit të dokumentacionit),e i cili në rekomandim të ekspertit teknik - komisioni i fundit i AK shpalle fitues OE dhe bene shkelje si të Aneksit 1 të FDT dhe LPPRK. Në vazhdim po ju përshkruajm në detale shkeljet që ka bere OE fituse së bashku me panel dhe ekspertin teknik përmes tabeles Pjesa III e FDT te AK:

PJESA - III. Prejardhia e mallrav te ofruara.

Nr	Përshkrimi i produkteve kërkuar nga AK	Lloji I produktit të ofruar: OE fitues nr.7 në RV dhe PCH	Prodhuesi nga OE fitues	Vendi I prodhimit nga OE fitues	Shkeljet-Mungesat e dokumenteve te OE fitues

1	Pajisje per zbulimin e rrjedhes se heliumit HLT 160 (helium leak detector HLT 160) komplet me paisje perciellese siq jane: 1.1 Remote Control se bashku me softuerin per te I shkarkuar te dhenat ne kompjuter.Remote Control duhet te funksionoj edhe pa kabllo "wireless", gjatesia e kabllos duhet te jete l=20m Shkarkimi I te dhenave ne kompjuter me ane te USB-se kabllove etj.Temote Control mund te jete edhe Touch screen display 1.2 Condesante Trap 1.3 Dosing and shut-off valve 1.4 Clamping ring 1.5 Gyp PVC l=20m, etj.	1.helium HLT 160 detector HLT 160) ASM 340 4.Condensate trap 5.Dosing valve 9.Instalimi dhe trajnimi	1.Pfeiffer Vacum Gmbh 4.Pfeiffer Vakum (adixen) 5.Vat vakumventil 9.Pfeiffer vaccum Gmbh	1.Gjermani 4.Francë 5.Zvicer 9.Gjermani	1.Iso-ja 9001:2008 e Pfeiffer vacuum gmbh I mungon, ka ne oferten e ISO-n 14001 2004 ska marrveshje ne mes te Pfeiffer vacuum gmbh Gjermani dhe Pfeiffer Vacuum Austria Gmbh e cila autorizon Scan Slovenija.Ne ofert e ka ISO-n 9001 3..8 te Trinos Vakum Systeme Gmbh e cila prodhon dhoma vakumi e jo detector helium per te cilen prap ska autorizim, shiqo shtojcen 4.Ska autorizim 5.Ska autorizim 9.Ndersa me pergjigjeje ne pytjet sqaruse ofron Scan d.o.o Slloveni
2	Bombola te heliumit + gypi me sperkatesin e heliumit	1.1x10 L bottle of helium(eshte dashte 2x10 me pytje sqaruse) 2.1xRegulation valve 3.2xHespraoy gua	1.Messer 2.Messer 3.Pfeiffer vakum (adixen)	1.Gjermani 2.Gjermani 3.Francë	1.Ska autorizim 2.Ska autorizim 3.Ska autorizim

Këtu shifet se si OE fitues e ndan oferten nëpër pozicione siqe e ka bere edhe AK në përshkrim për këtë arsye edhe paneli i mëparshëm vleresues i AK ndaras nëpër pozicione ka kërku autorizimet e në mungese të ofertueseve të përgjegjshëm ke anulu tenderin e jo siqe vepron Eksperti teknik i OSHP se spaska dert se paska pase raste ku po punojka ai me ju pranue dokumentacione shtese e kjo spe tejkalojka 5% e tansisi sipas tije po u konsiderojkan devijime te vogla (Vrejteje: edhe te pranohej e shkele piken 3 te nenit 59 LPP ku sguxon ta tejkaloj 2%) e pikerisht me keto devijime qe po i pranon eksperti teknik si te vogla e shpallin fitues OE, dhe komisioni i fundit versues i AK qe bene te njejtin gabim ploteson mbeshtetete ne rekomandimin e tije dhe thote se eshte vendim i OSHP dhe shpalle fitues OE ERA TRADE,nga kjo tani po kuptoj se paska ndrrim ne LPPRK luteni na njoftoni ku mundemi ti gjejm. Vrejteje: Ne letren standarde per eliminim AK ka potencu nenin 68 dhe 69 vertet jane ne LPPRK por jo edhe ne FDT,keto i kan mbulu me nenin 9.1dhe 9.2 te FDT,kerkesa te cilat i kemi te mbulura me oferten teknike. Mendojm se AK ka bere shkelje te LPPRK se nuk ka bere vlrsesim te drejte eshte shkele rende Nenin 59 LPPRK ku e ndryshon kushtin material dhe substancen dhe ka pranuar argumente te pabazuara te OE fitues,ka shkelje te UOPP neni 33.2;34.2,35.3;35.5;35.6 dhe 35.7. shkelje edhe me rende eshte se eksperti teknik merr rrolin e ekspertit shqyrtues te prokurimit, sepse krejte keto jane ne anen e dokumentacionit administrativ te cilat i perkasin ekspertit shqyrtues te prokurimit e jo specifikimeve teknike te cilat i perkasin ekspertit teknik. AK padrejte dhe pa argumente te qendrueshme te kerkume ne FDT dhe pyetjet sqaruese ka shpallur fituesin OE ERA TRADE. Propozojm te kthehet ne rishqyrtim lenda Furnizim me paisje për detektimin e heliumit KEKO-16-105-121. RT,te vazhdohet me proceduren e metejme te prokurimit dhe te shperblehemi me kontrat, me keto vlersime qe si kritere te marruna deri me tani ose ne te kunderten te anulohet tenderi e te perseritet lenda nga fillimi me skjarime rreth dokumentacionit te prodhuesve. Ne jemi ofertues

serioz me pershkrim teknik detal dhe dokumentacion mbeshtete te ofertes , te deshmuar sa iu perkete sjelljeve tona si kotraktor me AK-KEK-un.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 04.07.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....Furnizime/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 20.07.2016
Data e hapjes së ofertave 20.07.2016
Data e njoftimit për Dhënie 24.04.2017

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1Kërkesat e përshtatshmërisë:

- Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP),

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të LPP-se, Neni 65, siç është e cekur ne piken a deri ne i do të dorëzohen në formë të Aneksit
2. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesitper piken j deri ne q .
3. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata tatimore e vendit të themelimit të Operatorit ekonomik, se Operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë ne pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.

Për piken 2 dhe 3 kërkohet vetëm nga Operatori ekonomik qe propozohet për dhënien e kontratës

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2. Regjistrimi i TVSH;
3. Regjistrimi i numrit fiskal;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e çertifikatës së biznesit);
2. Kopja e TVSH-se;
3. Kopja e numrit fiscal

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar NA

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kerkesat:

1. Autenticitetit i produkteve dhe cilësisë
2. Katalogje te produkteve
3. Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Autorizimi nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar (të bashkangjitur kopja e marrëveshjes e distributorit me prodhuesin), për shitjen e produkteve qe ofroni
2 Katalog dhe/apo vizatim të vërtetuar nga prodhuesi me përshkrimet teknike detale për te gjithë

	artikujt që ofertoni. Në katalog/vizatim (specifikim) të nënvizohen artikujt që keni ofertuar për çdo pozicion të kërkuar në këtë DT.
3	Kopja e Certifikates se ISO Standardit 9001:2008 e prodhuesit .

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"OMEGA-1 "	Podujevë	33.748.00 €	JO
2.	"PROFITECH"	Mitrovicë	38.890.20 €	JO
3.	"N.T.P EUROLAB"	Prishtinë	36.420.00 €	JO
4.	"AUDIT GROUP"	Prishtinë	47.672.00 €	JO
5	"RH COM"	Obiliq	44.840.00 €	JO
6	"NTSH BIZUN"	Prishtinë	40.915.00€	JO
7	"ERA TRADE"	Prishtinë	43.570.32 €	JO
8	"UNION L.L.C"	Prishtinë	49.560.00€	JO
9	"ERA MED"	Prishtinë	49.800.00€	JO
10	"INLINE ENGINEERIGNG"	Prishtinë	49.560.00€	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 27.07.2016, *konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë dhjetë (10) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Ramush Ramadani
- - Anëtar i komisionit - Arben Avdiu
- - Anëtar i komisionit – Hasan Mexhuani

Data e mbarimit të vlerësimit: 12.04.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....12.04.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Pas vlerësimeve te detalizuara te ofertave te OE-ve, komisioni propozon te shpallet fitues kompania me ofertën e përgjegjshme me çmim me te ulet "Era Trade".

Analiza dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues - teknik (N. 113, 114)

Eksperti teknik, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi nr.1

Pas vendimit te PSH-se, me nr 07/17, AK-ja, e ka kthyer ne Ri-vlerësim dhe pas ri-vlerësimit te ofertave e shpall te papërgjegjshëm OE ankues "Audit Group", ndërsa rekomandon për kontratë OE "Era Trade". OE ankues ne ankesën e tij e atakon OE te rekomanduar për kontratë, i cili pretendon se OE "Era Trade", është i papërgjegjshëm.

Sqarimi nr.2

Gjate fazen se ri-vleresimit AK-ja, me daten: 22.03.2017, ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar per kontratë "Era trade", ne lidhje me autorizimet sipas kerkeses se DT-se per pozicionet e kërkuara ne dosje te tenderit: 1.5, 2.1, 2.2 dhe 2.3.

OE ankues me daten: 24.03.2017, ne përgjigje i ka bashkangjitur te gjitha autorizimet e kërkuara nga AK-ja ne kerkesen e e saj te dates: 22.03.2017.

Sqarimi nr.3

OE ankues ne email, e datës: 24.03.2017, sic u cek edhe me lart i ka dorezuar te gjitha dokumentet e kërkuara nga AK-ja, mirëpo pas analizimit te këtyre autorizimeve konstatoj se autorizimi i leshuar nga prodhuesi MESSER për aktivitetin e prokurimit ne fjal, është lëshuar me datën: 27.12.2016, qe do te thot se eshte ne kundërshtim me nenin 72.3 te LPP-se ku thuhet se, citoj: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Ne rastin konkret OE ankues e ka dorëzuar autorizimin e prodhuesit Messer pas afatit te dorëzimit te ofertave te dates: 20.07.2016, pra është ne kundërshtim me dispozitën e nenit te lartpërmendur dhe kjo njëherit e bene te papërgjegjshëm këtë operator ekonomik. Ky pretendim është i qëndrueshëm.

Sqarimi nr.4

Pas analizimit te dokumentacionit dhe shkresave te lendes sqaroj se sipas raportit te vlerësimit vetëm OE i rekomanduar nga ana e AK-se është i përgjegjshëm, andaj, ne baze te konstatimit te lartpërmendur OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Poashtu OE ankues është i papërgjegjshëm për arsye nuk i ka plotësuar te gjitha pikat e FDT-se, lidhur me autorizimet e prodhuesve dhe njëherit konstatoj se nuk i ka te gjitha certifikatat ISO te cilat me te drejt i ka përmendur edhe AK-ja, ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar.

Prandaj, ne mungesë te ofertave te përgjegjshme ky aktivitet i prokurimit duhet te anulohet dhe te ritenderohet nëse edhe me tutje ka interes AK-ja.

Mendimi i ekspertit shqyrtues - teknik :

- Eksperti shqyrtues - teknik bazuar në sqarimet e cekura në raport, i propozon panelit shqyrtues që për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me paisje per detektimin e helimut"** me numër të prokurimit KEKO 16/105/121, **të aprovoj vendimin e AK - KEK, njoftimin për anulim**, ndërsa ankesa e operatorit ekonomik **"Audit Group"**, të aprovohet si **pjesërisht e bazuar.**